



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT  
KRYETARI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Burrel, më \_\_\_\_\_.2021

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Drejtuar:** Operatorit Ekonomik: “CARA” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **K07729920F**

**Adresa:** Dibër, Burrel, BURREL, lagjja "Pjetër Budi", rruga “Abdi Mati”, Ndërtesë private Nr.10.

Procedura e prokurimit: “E Hapur e Thjeshtuar - Punë”, prokurim elektronik

Numri i referencës së procedurës: **REF-07781-10-11-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Rikonstruksioni i Qendrës Shëndetësore Lis, Ambulancës Zenisht, dhe Ambulancës Mallunxë**”, me fond limit **11 199 324** (njëmbëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e njëzet e katër) **lekë pa TVSH**, ndarë për vitin **2021** në vlerën: **10 462 686.75** (dhjetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e pesë) **lekë pa TVSH**, nga grandit në vlerën: 2 717 500 (dy milion e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) **lekë pa TVSH**, dhe nga të ardhurat në vlerën: 7 745 186.75 (shtatë milion e shtatëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e pesë) **lekë pa TVSH**, dhe për vitin **2022** në vlerën: **736 637.25** (shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë pikë njëzet e pesë) **lekë pa TVSH**, nga grandit, me afat realizimi: **3 (tre) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.**

Publikime të mëparshme: nuk ka patur

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 151, datë 18 Tetor 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Operatori Ekonomik: “CARA” Sh.p.k.,** me numër Nipt-i: **K07729920F**

**Vlera: 11 000 314** (njëmbëdhjetë milion e treqind e katërmëdhjetë) **lekë pa TVSH**

2. Operatori Ekonomik: “AVDULI” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J667033060**  
Vlera: **9 845 167** (nëntë milion e tetëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

1. Operatori Ekonomik: “AVDULI” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J667033060**

***Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:***

- ❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “AVDULI” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/Kualifikimit, si më poshtë:

- I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1, gërma “a” / 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

*“1. Ofertuesi duhet të paraqesë:*

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8...”*

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se në *Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit*

1. Nuk është plotësuar saktë seksioni A “*Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit*”;
2. Në seksionin B “*Deklarata “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura*” pika 8, 9 dhe 10 e saj, nuk ka deklaruar se nuk ka patur konsultim, komunikim... me ndonjë konkurrent tjetër, edhe pse në pikën 6 të saj ka deklaruar se ka përgaditur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pra, rezulton të jetë kontradiktor në deklaratimet e kryera.
3. Si dhe në seksionin D “*Deklarata “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës*” pika 3 e saj, nuk ka deklaruar se nuk ka masë efektive ligjore të vendosur nga ISHPSHSH, ku bazuar në nenin 76 pika 3, gërma “a” duhet të s’kualifikohet.

- II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5, gërma “d”/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

*d) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë dhe vetë Drejtuesi Teknik) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe në rast të shpalljes fitues, përpara nënshkrimit të kontratës, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

- *Librezë pune (përkatëse)*
- *CV përkatëse*

- *Kontratë noteriale pune (e vlefshme)*
- *Diplomë*

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se *Deklarata e paraqitur për caktimin e Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt*, nuk është nënshkruar nga drejtuesi teknik i punimeve, por vetëm nga administratori i shoqërisë, si dhe nuk ka një deklaratë të tillë nga vetë drejtuesi teknik.

III. Në preventivin e ofertës së paraqitur, vlera e ofertuar është përlllogaritur gabim, pasi në preventivin për rikonstruksionin e Qendrës shëndetësore Lis, tek shuma totale (Shuma II - Pajisje) nuk është kryer përlllogaritja e të 2 (dy) shumave të ofruar për *“Pajisje Elektrike”* – në vlerën: 315 650 lekë, dhe *“Pajisje ngrohje”* – në vlerën: 1 110 000 lekë, ku shuma totale e tyre rezulton në vlerën: 1 425 650 lekë, por është lënë shuma totale 1 110 000 lekë pa TVSH, që është vlera e paisjeve ngrohëse.

Referuar përlllogaritjeve të kryera, rezulton se shuma absolute e korigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar, ku bazuar në nenin 82 pika 3 gërma “c” e VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, oferta refuzohet.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë Operatorin Ekonomik: **“CARA”** Sh.p.k., me seli: *Dibër, Burrel, BURREL, lagjja “Pjetër Budi”, rruga “Abdi Mati”, Ndërtesë private Nr.10*, me numër Nipt-i: **K07729920F**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **11 000 314** (njëmbëdhjetë milion e treqind e katërbëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si **Oferta e suksesshme**.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, *“Për Prokurimin Publik”*.

**Titullari i Autoritetit Kontraktor**